



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:155435  
Datë: 07.05.2024  
Numri i dokumentit: 05659763

**C.nr.2577/2022**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, **Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtar Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridiko- -kontestimore të paditësit F.H. me numër personal ..... me vendbanim në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson N.M. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës-kundër propozueses Q.K. të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kthimi i pronës së eksproprijuar, vlera e kontestit 3,100.00, jashtë seancës, me datë 07.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Hedhet poshtë e pasafatshme**, padia e paditësit F.H. nga Prizreni, me numër të lëndës C.nr.2577/2022, kundër të paditurës Q.R.K. me objekt kontesti kthimi i pronës së shpronësuar.

**A r s y e t i m**

Paditësi F.H. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij N.M. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datën 01.08.2022, ka parashtruar padi, ndaj të paditurës Q.R.K. me seli në Prishtinë, për çështjen juridike kthimi i pronës së shpronësuar, vlera e kontestit 3,100.00. I autorizuari i paditësit, në padinë e paraqitur ka theksuar se paditësi është ish pronar i paluajtshmërisë së shpronësuar të shënuar si ngastra kadastrale me nr.170/5 dhe 170/6 ZK Dushanovë, ndërsa e paditura Qeveria e Kosovës është shfrytëzues i shpronësimit objekt i kërkesëpadiësë. E paditura për qëllime publike legjitime, ndërtimi i autostradës Vermicë-Merdarë, segmenti 1, 2 dhe 3, në bazë të nenit 4 par.3 të Ligjit për Shpronësim të Kosovës, me vendim përfundimtar nr.6/12, të datës 27 prill 2011, ka kryer ndër të tjera shpronësimin e ngastrës kadastrale 170/5 dhe 170/6, të regjistruar sipas certifikatës nga lista nr.388 ZK Arbanë (Dushanovë), në sipërfaqe të përgjithshme prej 50 ari, në pronësi të këtui paditësit F.H. Edhe pse nga vendimet përfundimtare dhe realizimit të autostradës e cila tani është në funksion, e paditura organi i shpronësimit edhe pas kalimit të afatit prej 19 vjetësh nuk i ka shfrytëzuar ngastrat kadastrale në fjalë, gjegjësisht sipërfaqet prej 50 ari, sipërfaqja e së cilës ka ngelur jashtë rrjetit të telit në largësi prej rreth 500 m, që do të thotë se kjo sipërfaqe nuk është shfrytëzuar dhe nuk po shfrytëzohet për nevojat e autostradës dhe nuk është në përdorim sepse është e shpronësuar, çka paraqet shkelje të nenit 27 par.1 të Ligjit për Shpronësim. Andaj, konform nenit të lartcekur, paditësi kërkon që prona e shpronësuar ti kthehet përsëri në pronësi të paditësit. Po ashtu ka shtuar se në bazë të informatave të arritura dhe provave materiale me

të cilat disponon paditësi, prona në të cilën paditësi ka njëfarë përparësie juridike, nga ish Q.K. apo nga individët për përfitime dhe interesat e tyre personale, është dhënë me nën qira Ndërmarrjes “Real Estate Kosova”Sh.P.K, me seli në Fushë Kosovë, për qiranë vjetore 30 cent për 1 m<sup>2</sup>.

Me datën 19.04.2024, i autorizuari i paditësit ka paraqitur edhe propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, me propozim që palës së paditur dhe personave të tretë të iu ndalohen punimet, tjetërsimi, fshehja, ngarkimi apo ndërmarrja e ndonjë veprimi tani dhe në të ardhmen në ngastrën kadastrale nr.001740-4 ZK Dushanov, i cili propozim me aktvendimin e datës 03.05.2024, është Refuzuar i pabazuar.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kjo pasi pas shqyrtimit paraprak të padisë, provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe bazuar në nenin 27 par.1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, i cili përcakton se “*Personi, të drejtat pronësore të të cilin në pronën e paluajtshme janë shpronësuar, ka të drejtën, e cila mund të ushtrohet vetëm brenda dhjetë viteve pas hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar, të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente dhe të kërkojë nga gjykata lëshimin e një urdhri për rivendosjen e të drejtës pronësore në pronën përkatëse, plotësisht ose pjesërisht, nëse të gjitha kushtet në vijim janë plotësuar:...*”, vërtetohet se Vendimi Përfundimtar me Nr.06/12, ka hyrë në fuqi me datën 10.05.2011 (datën e shpalljes në gazetën zyrtare), ndërsa paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka paraqitur me datën 01.08.2022, (pas 11 vitesh) pra pas kalit të afatit të paraparë. Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që me nenin 391 par.1 pika f të LPK-së, është paraparë që “*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: ...f) padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj*”, ndërsa me nenin 27 par.1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme është përcaktuar se brenda 10 viteve pas hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar mund të ushtrohet ankesë pranë gjykatës kompetente, mbi këtë bazë gjykata, konstaton se padia e paditësit është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor prej 10 vitesh.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata në kuptim të nenit 27 par.1 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe nenin 391 par. 1 pika f , të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
2022:155435, 07.05.2024

**G j y q t a r i**

**Baki Shigjeqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit.